

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

Nr. 16 Regj.

Shkodër më: 19/07/2022

DËFTESË – KOMUNIKIMI

Drejtuar:

Qendres Kontabile e Regjistrimit

Adresa:

Bashkëngjitur me këtë shkresë ju dërgojmë kopjen e Vendimit

shkurtuar për sigurimin e
partesë padre Nr. 16 Datë 19.07.22 bërë nga _____


Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (Sf. et. y.)

Shpërndarësi

Mora dijeni më Datë: 22/07/2022

Ilirije Jorg

(Signature)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

Nr.Regj.Them.16 (90100-01661)

Nr.Vendimi 16 (2984)

Data e ardhjes 19.07.2022.

Data 19.07.2022.

VENDIM

I shkurtuar

“Për sigurimin e kërkesëpadisë”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkoder, e perbere nga:

Andri Ymeri - Gjyqtar

sot më datë 19.07.2022, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën e paraqitur nga:

KERKUES: **Mark Molla**, i biri i Ndoc dhe Lule, i dtl. 20.05.1961, lindur në fshatin Malagji, Temal dhe banues në Shkodër, Rr. Qafa e Agrit, pallati nr.7.

PERSON I TRETE:

- 1. Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë “UKSH” sha**, me seli në Shkodër, rruga “13 dhjetori”;
- 2. Bardh Spahia**, me adresë njoftimi Bashkia Shkodër
- 3. Avokatura e Shtetit Shkodër**
- 4. Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktëve të Interesave (ILDKPKI)**, me adresë: Rruga Reshit Collaku, Tiranë.
- 5. Këshilli i Ministrave, Tiranë**
- 6. Qendra Kombetare e Regjistrimit**
- 7. Bashkia Shkodër**
- 8. Prefekti i Qarkut Shkodër**
- 9. Voltana Ademi, L. Arra e Madhe Shkodër**
- 10. Arvid Bushati**, me adresë njoftimi Bashkia Shkodër
- 11. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

OBJEKTI: Sigurimin e padisë duke vendosur pezullimin e vendimit nr.16, datë 18.07.2022, vendimit nr.17, date 18.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetës kanalizime Shkodër sh.a deri në marrjen e vendimit të formës së prerë nga gjykata, duke detyruar të paditurin që të mos kërkojë rregjistrimin e këtyre vendimeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit deri në zgjidhjen me vendim përfundimtar të këtij konflikti për padinë e paraqitur me datë 19.07.2022. (Bashkengjitur kërkesë padia).

BAZA
LIGJORE: Neni 202 i K.Pr.Civile
Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqërite tregtare”
Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për diskriminimin”, neni 15, 38 e vijues
Ligjir nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”



Ligji 139/2015 “Për qeverisjen vendore”
Kodi Civil
Kodi i Punës

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën në dhomë këshillimi

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.
2. Sigurimin e padisë duke vendosur pezullimin e vendimit nr.16, datë 18.07.2022, vendimit nr.17, date 18.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetës kanalizime Shkodër sh.a deri në marrjen e vendimit të formës së prerë nga gjykata, të vendimit që do zgjidhë çështjen civile të regjistruar mbi bazën e kërkesë padisë, që i është bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Një kopje e shkurtuar e këtij vendimi ti njoftohet menjëherë palëve ndërgjyqëse të gjykuara në mungesë të tyre;
4. Shpenzimet gjyqësore mbeten siç janë bërë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Shkodër, nga ndërgjyqësit, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Shkodër, sot me datë 19.07.2022.

**Gjyqtar
Andri Ymeri**



dt 18.07.2022
one 0958

Shkoder me 19/07/2022

KERKESE PADI

DREJTUAR: GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR SHKODER

PADITES: Mark Molla, i biri i Ndoc dhe Lule, i datelindjes 20.05.1961, lindur ne fshatin Malagji, Temal banues ne Shkoder Rruga Qafa e Agrit Pallati nr.7

I PADITUR: Asambleja e Pergjithshme Ujesjelies – Kanalizime Shkoder sh.a, adresa Bashkia Shkoder

OBJEKTI: 1. Pavlefshmerine e vendimeve nr.16 date 18.07.2022, nr.17 date 18.07.2022 te leshuara nga Kryetari i Asamblese se Pergjithshme te Ujesjelies - Kanalizime Shkoder sh.a

2. Ndalimin e diskriminimit, marrjen e mases per te riparuar demet e shkatuara nga diskriminimi.

3. Detyrimin e pales se paditur te me demshperbleje

Person I Trete

Avokatura e Shtetit Shkoder

ILDKPKI Inspektoriati i Larte I Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konflikteteve te interesave Rruga Reshit Coillaku Tirane

Keshilli i Ministrave Tirane

Qendra Kombetare e Rregjistrimit

Bashkia Shkoder

Prefekti i Qarkut Shkoder

Znj.Voltana Ademi lagje Arra e Madhe Shkoder

Z.Arvid Bushati me adrese njoftimi Bashkia Shkoder

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Shkoder

BAZA LIGJORE: Ligji me numër 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 134, 148, 158 e vijues, Ligji me numër 10221, datë 04.02.2010 “Për diskriminimin” neni 15, 38 e vijues, Ligji me numer



9367, date 07.04.2005 "Per parandalimin e konfliktit te interest ne ushtrimin e funksioneve publike" Ligji 139/2015 "Për qeverisjen vendore" Kodi Civil, Kodi i punës.

Une Mark Molla ushtroj detyren e Administratorit te Shoqerise Ujesjelles-Kanalizime Shkoder sh.a qe nga data 13.11.2015. Nder keto vite pune qe une drejtoj Ujesjelles-Kanalizime Shkoder ka permiresuar ndjeshem performance dhe treguesit e saj. Ky fakt i pasqyruar ne vleresimet me sistem pikezime te marra nga qeveria si dhe nga projektet dhe mbeshtetja qe kane treguar donator te huaj referuar vetem rezultatve ne pune.

Me date 18.07.2022 jam njoftuar me telefon nga punonjesit e Institucionit ku une punoj per vendimet nr.16 date 18.07.2022, nr.17 date 18.07.2022 te leshuara nga Kryetari i Asamblese se Pergjithme te Ujesjelles-Kanalizime sh.a Shkoder.

Ne vleresimin tim keto vendime jane ne kundeshtim te hapur me ligjin dhe i kundershtoj si me poshte vijon

Se pari- Kryetari i Asamblese se Pergjithshme te Ujesjelles – Kanalizime Shkoder nuk e ka tagrin qe te me liroje nga detyra e Administratorit te Ujesjelles Kanalizime Shkoder. Kjo pasi referuar nenit 154 te Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" pika f kete kompetence e ka Keshilli i Administrimit, *f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;*

Neni 157 I po ketij ligji parashikon se *Shkarkimi 1. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit të administrimit, me shumicë të thjeshtë votash. Kjo e drejtë nuk mund të përjashtohet nga statuti apo me marrëveshje. Paditë, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi. 2. Anëtari i këshillit të administrimit, i cili është zgjedhur në përputhje me pikën 3 të nenit 155 të këtij ligji, mund të shkarkohet me vendim të aksionarëve të pakicës, që e ka zgjedhur. Kur kushtet e parashikuara në statut për këtë emërim të veçantë nuk janë më në fuqi, asambleja e përgjithshme mund ta shkarkojë anëtarin në fjalë me shumicë të thjeshtë votash. 3. Këshilli i administrimit, me shumicë të thjeshtë votash, mund t'i kërkojë gjykatës përkatëse të shkarkojë një anëtar, nëse ai ka shkelur detyrat e parashikuara në pikën 3 të nenit 163 të këtij ligji.*

Neni 158 parashikon krejtesisht qarte emerimin e administratorit konkretisht:

Administratorët 1. Këshilli i administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen. Anëtarët e këshillit të administrimit mund ta kryejnë detyrën e administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit janë anëtarë të pavarur, që nuk kryejnë këtë detyrë. Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji. Statuti mund të vendosë rregulla të

posaçme për emërimin. 2. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të një shoqërie të kontrolluar dhe administratori i një shoqërie të kontrolluar nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të shoqërisë mëmë. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është absolutisht i pavlefshëm. Të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji. 3. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen: a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë; b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare; c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme; d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë; dh) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera; e) të raportojnë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë; ë) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut. 4. Detyrat, që i cakton ligji këshillit të administrimit, nuk mund t'u delegohen administratorëve. 5. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, administratorët duhet të informojnë menjëherë kryetarin e këshillit të administrimit. 6. Nëse shoqëria emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë shoqërinë në mënyrë të përbashkët. Statuti ose rregulloret, të miratuara nga këshilli i administrimit, mund të parashikojnë ndryshe. 7. Këshilli i administrimit mund t'i shkarkojë administratorët në çdo kohë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Kryetari i Asamblese se Përgjithshme nuk ka kompetencë për të liruar nga detyra administratorin, të lesheje akte të riemërimit të Administratorit të ri, por për një fakt të tillë duhet t'i drejtohej gjykatës.

Në nenin 151 të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" parashikohet:
1. Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës kompetente shfuqizimin e vendimeve të administratorëve dhe sipas rastit, të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës, kur këto vlerësohen si shkelje të rënda të ligjit ose të statutit.

Ligji në vlerësimin tim ka parashikuar garanci të tillë për vendimarrjet e Administratorit dhe Këshillit të Administrimit rezulton qartë se kjo garanci duhet të jetë edhe për aktet e Asamblesë së Përgjithshme, me qëllim mbrojtjen nga abuziviteti në ushtrimin e detyrës nga anëtarë të ndryshuar të saj.

Vendimet me numër 16 dhe 17, datë 18.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH janë në kundërshtim me dispozita urdhëruese të ligjit dhe konkretisht akteve ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punësimit, kohëzgjatjen e mandatit të Administratorit, kompetencën për vlerësimin e akteve që këto vendime kanë revokuar.

Si akte që janë në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të ligjit këto vendime duhet të vleresohen si veprime juridike absolutisht të pavlefshme, bazuar në parashikimet e nenit 92/1, pika "a" të K.Civil, sipas të cilit: Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit;

Si veprime juridike absolutisht të pavlefshme këto vendime nuk duhet të prodhojnë asnjë pasojë juridike, si në drejtim të vlefshmërisë së akteve që ato kanë revokuar, ashtu edhe në drejtim të vlefshmërisë së akteve të tjera të dala pas revokimit të akteve të para.

Se dyti: Vendimi nr.16 date 18.07.2022 leshuar nga Kryetari i Asamblese se Pergjithshme per lirim tim nga detyra eshte i kundraligjshem, diskriminues. Kjo pasi, vendimi i mesiper ka ardhur si rezultat mos mbeshtetjes nga ana ime gjate gares per kryetar bashkie. Vendimi per lirim tim nga detyra eshte nje shenje hakmarrjeje nga Kryetari i Bashkise, i pa arsyetuar se pse lirohem nga detyra, duke mos marre ne konsiderate vleresimet positive qe ka marre nga Qeveria Shqiptare Ujesjelles Kanalizime Shkoder. Keshtu rerferuar nenit 3 të ligjit nr 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet se Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi."

Ndërkohë në nenin 1 të këtij ligji parashikohet se : "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."

Trajtimi im diskriminues nga pala e paditur ka ardhur për shkaqe politike dhe konkretisht për shkak të mos përkrahjes të kandidaturës të Kryetarit të Bashkisë, gjatë zgjedhjeve lokale.

Neni 38 të ligjit nr 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi":

"Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme."

Neni 12 i ligjit nr 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikon se: Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë

trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës; ç) anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfituar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi.

Se treti: Me heret Kryetari i Asamblese se Pergjithshme i Ujesjelles Kanalizime Shkoder me vendimin nr.09 date 16.05.2022 "Per revokimin e vendimit te Asamblese se Pergjithshme nr.05 date 24.03.2022 "Per riemerimin e administratorit te ujesjelles – kanalizime Shkoder sh.a me ka revokuar riemerimin si Administrator i Ujesjelles Kanalizimeve Shkoder. Theksoj se **nuk me ka larguar nga puna por me ka revokuar vendimin per zgjatjen e afatit.** (nuk jam i sigurte per qellimin qe ka pasur, revokimin e vendimit per zgjatjen e afatit 3 vjecar dhe riemerimin per nje afat tjeter me te shkurter apo largimin nga detyra ne nje moment tjeter nuk edi)

Vendimin e mesiper e kam kundërshtuar gjyqesisht duke paditur Asamblene e Pergjithshme te Ujesjelles Kanalizimeve Shkoder, duke kundërshtuar vendimin nr.09 date 16.05.2022 "Per revokimin e vendimit te Asamblese se Pergjithshme nr.05 date 24.03.2022 "Per riemerimin e administratorit te ujesjelles – kanalizime Shkoder sh.a. Konflikti gjyqesor i mesiperme eshte per gjykim ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Shkoder dhe deri ne keto moment nuk ka vendim marrje nga Gjykata.

Ne vleresimin tim lirimi nga puna eshte ndikuar edhe nga fakti se kam paditur Asamblene e Pergjithshme te Ujesjelles Kanalizimeve Shkoder per kundërshtimin e vendimit per revokimin e riemerimit tim. Ne shenje hakmarrjeje Kryetari i Asamblese me ka liruar nga detyra.

Ligji me numer 9367, date 07.04.2005 "Per parandalimin e konfliktit te interest ne ushtrimin e funksioneve publike" neni 1 qellimi I ligjit eshte garantimi I nje vendimmarrjeje te paanshme, transparente, ne interesin me te mire te mundshem te publikut e te besimit ndaj institucioneve publike, nepermjet parandalimit te konfliktit te ndermjet interesave publike dhe atyre private ten je zyrtari ne ushtrimin e funksioneve te veta.

Neni 2 objekti i ketij ligji eshte percaktimi I rregullave, mjeteve, menyrave, procedurave, pergjegjesive dhe kompetencave per identifikimin, deklarimin, rregjistrimin, trajtimin dhe denimin e rasteve te konfliktit te interesave.

Neni 3 konflikti I interest eshte gjendja e konfliktit ndermjet detyres publike dhe interesave private ten je zyrtari, nete cilen ai ka interes private, te drejteperdrejte ose te terthorte, qe ndikojne, mund te ndikojne ose duket sikur ndikojne ne kryerjen ne menyre te pa drejte te detyrave dhe pergjegjesive te tij publike

Ne keto kushte Kryetari I Asamblese se Pergjithshme eshte ne kushtet e konfliktit te interest pasi une personalisht e kam paditur ne gjykate me heret dhe aktualisht jemi ne nje process gjyqesor. Ka interesa private referuar ligjit. Neni 5 I po ketij ligji nder te tjera parashikon se interest private te zyrtarit ne rastin konkret te Kryetarit te Asamblese jane interesa qe perputhen, permbajne, bazohen ose burojne nga pika v) mardhenie te njohura te miqesise apo te armiqesise. Ne vleresimin tim jemi ne kushtet e armiqesise, pasi jemi ne konflikti gjyqesor dhe hnuq e kam mbeshtetur si candidature. Fakti qe jemi ne mardhenie armiqesore eshte pranuar, shprehur

Në nenin 11/1 të K.Punës parashikohet: Gjatë ushtrimit të të drejtave dhe përmbushjes së detyrimeve, punëdhënësit, përfaqësuesit e punëdhënësve, punëmarrësit dhe përfaqësuesit e punëmarrësve duhet të udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, drejtësisë dhe bashkëpunimit me njëri-tjetrin. Ata informojnë njëri-tjetrin për të gjitha faktet, kushtet, si dhe ndryshimet e tyre, të cilat janë të rëndësishme për ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve.

Nga veprimet e pales se paditur me eshte shkatuar dem pasuror dhe jo pasuror

Po keshtu ju bej me dije se vendimi per lirimin tim nga detyra eshte bere ne nje moment ku une kam qene me raporte mjekesore. (bashkengjitur raporta mjekesore)

Neni 608 i K.Civil:

Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

Neni 609 i K.Civil: Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit

Neni 625 i K.Civil:

Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur: a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij; b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij; c) është cenuar e drejta e emrit; ç) është cenuar respektimi i jetës private; d) është cenuar kujtimi i një të vdekuri.

Nga interpretimi i dispozitave të mesiperme rezulton se kushtet qe te linde detyrimi nga shkaktimi i dëmit jashte kontraktor jane kater. Konkretisht:

- a) te ekzistojë dëmi;
- b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose mosveprimit;
- c) ekzistenca e fajit;
- d) lidhja shkakesore midis veprimit ose mosveprimit dhe pasojës (demit) të ardhur.

Sa me siper kerkoj:


1. pranimin e kerkese padise sipas objektit

2. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales se paditur

Bashkengjitur

1. Fotokopje e ID
2. Vendimi nr.16 date 18.07.2022 leshuar nga Asambleja e Pergjithshme e Ujesjelles Kanalizime Shkoder sh.a
3. Vendimi nr.17 date 18.07.2022 leshuar nga Asambleja e Pergjithshme e Ujesjelles Kanalizime Shkoder sh.a
4. Ekstrakt Historik
5. Raporte mjekesore

Mark Molla

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Mark Molla', written over a horizontal line.

